



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 02.08.2021

NJOFTIM PUNËSIMI

Bazuar në në Vendimin nr.1151, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendrore”, AZHBR shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuara si mëposhtë vijon :

I SEKTORI I PROMOCIONIT DHE KOMUNIKIMIT:

SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria IV-b

Detyrat kryesore:

1. Menaxhon rrjetet sociale të AZHBR- së dhe përditëson çdo informacion mbi aktivitetet dhe trajnimet e ndryshme që realizohen.
2. Realizimi e montazhit në videot promovuese gjatë aktiviteteve të ndryshme.
3. Asiston në përgatitjen e materialeve me karakter promociional, informues apo statistikor, në përputhje me kërkesat, nevojat dhe tendencat e tregut dhe fermerëve, me kërkesat kombëtare e rajonale të zhvillimit bujqësor dhe rural, me objektivat e planeve dhe strategjive kombëtare të sektorëve bujqësor e rural.

Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:

1. Diplomë e nivelit “Master Shkencor”, në të gjitha fushat e arsimit të lartë.
2. Njohuri shumë të mira kompjuterike dhe nivel shumë i lartë i anglishtes;
3. Aftësi për të ofruar drejtim teknik, menaxhim dhe kontroll
4. Aftësi të mira menaxhuese për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve, të fondeve / pagesave me banke, në sistemin e thesarit, si dhe me aftësi në përdorimin e burimeve.
5. Aftësi të mira menaxhimi, komunikimi, inicaitive për të propozuar zgjidhje teknike për probleme komplekse dhe aftësi bashkëpunimi.

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

1. Njohuri mbi organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural,
2. Njohuri mbi Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike,
3. Njohuri mbi Ligjin për bujqësinë dhe zhvillimin rural
4. Njohuri mbi ligjin për të drejtën e informimit.
5. Njohuri mbi Ligjin “Për funksionimin dhe organizimin e administratës publike”;
6. Njohuri mbi Ligjin “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
7. Njohuri mbi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)”;
8. Njohuri mbi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE-së për RSH, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit, në fushën "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural (IPARD)";

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 06.08.2021, ora 14.00 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollësia”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL